



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 5284 prot.

Tiranë, më 15.3.2022

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të hapur

Drejtuar: **DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE**  
**DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE**  
**DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE**  
**INTERGRIMIT EUROPIAN**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në mbështetje të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 "Për Personelin e Administratës Doganore", i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionin:

- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, Zyra e Pikës së Hyrjes/Daljes, në Degën Doganore Tiranë, Kategoria C3 (1) një vend pune.

**Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:**

1. të kenë shtetësi shqiptare;
2. të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;
4. të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
5. të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
6. të kenë arsim të mesëm.

**Përshkrim përgjithësues i punës:**

Doganieri i peshores/ pikës së kontrollit përgjigjet tek Përgjegjësi i Zyrës së Operacioneve Doganore dhe në raste të veçanta edhe tek Kryetari i Degës Doganore, për kryerjen e punës në zyrën e operacioneve doganore, ku përfshihen kontrolli i elementëve të sigurisë, regjistrimi, peshimi dhe kontrolli në hyrje e dalje.

**Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:**

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim;
2. Curriculum Vitae
3. Diplomë e shkollës së mesme e noterizuar
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
5. Vërtetim nga Gjykata
6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore
9. Fotokopje të letërnjoftimit
10. Fotokopje të librezës së punës
11. Fotokopje të kurseve kualifikuese.
12. Letër referencë dhënë nga punëdhënësi/eprori direkt i pozicionit të fundit.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

***Procedura e konkurimit*** do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

- a) Pervojën
- b) Kualifikimin
- c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

**Rezultatet e konkurimit**

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 25.03.2022, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra Sekretari/Protokollit.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Genti Gazheli**

